



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:069318
Datë: 21.03.2025
Numri i dokumentit: 07022423

C.nr.604/24

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtar Vegim Maloku, në çështjen juridiko-kontestuese të paditëses Z. Sh. nga P., të cilën e përfaqëson Liridon Tafa avokat në Pejë, rruga "Bill Clinton" numër 45, kundër të paditues Komuna e Pejës – Drejtorati Komunal i Arsimit, baza juridike, kompensim për shpenzime të udhëtimit, vlera e kontestit 1000 euro, jashtë seance me datë 21.03.2025, bie këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET së është tërhequr padia e datës 29.02.2024, e parashtruar nga paditësja Z. Sh. nga P., kundër të paditues Komuna e Pejës – Drejtorati Komunal i Arsimit, baza juridike, kompensim për shpenzime të udhëtimit, vlera e kontestit 1000 euro.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj në këtë gjykatë me datë 29.02.2024, ka parashtruar padi kundër të paditues, nga baza e kontestit: kompensim për shpenzime të udhëtimit, vlera e kontestit 1000 euro.

I autorizuari i paditëses me parashtruesen e datës 18.03.2025 të dorëzuar pranë kësaj gjykate, e ka bërë tërheqjen e padisë ndaj të paditues.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 261 par. 1, 3 dhe 4 e lidhur me nenin 387, par 1, pika "c" të Ligjit për procedurën kontestimore vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2024:069318, C.nr.604/24, 21.03.2025

Udhëzim juridik: *Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa ne kuptim të dispozitës së nenit 261 par. 4 e LPK-së.*

G J Y Q T A R I
Vegim Maloku